

[Shpalljet ▼](#)[Kthehu](#)

#01038

INSTITUTI I STATISTIKAVE

**Instituti i Statistikave (INSTAT), kërkon të punësojë punonjës me kontratë pune në pozicionet:
" 3 (tre) Specialist Programist IT" në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave**

TITULLI I SHPALLJES "SPECIALIST PROGRAMIST IT, NË KUADËR TË CENSIT TË POPULLSISË DHE BANESAVE"

Termat e referencës:

- Zhvillon, teston, mirëmban dhe dokumenton programe për kompjuter për proceset e ndryshme të Censit të Popullsisë dhe Banesave.
- Ndiemon në kontrollin e aplikacioneve të reja përpara se të zbatohen për të përcaktuar lehtësinë e përdorimit dhe për të gjetur problemet e mundëshme.
- Harton programe për të gjeneruar raporte sipas nevojave.
- Krijon dhe mirëmban bazat e të dhënave të aplikacioneve për të cilat është përgjegjës.
- Trajnon stafin e suportit të TI në terren, ndihmon në procesin e instalimit dhe konfigurimit të pajisjeve për mbledhjen e të dhënave.
- U përgjigjet kërkesave të përdoruesve për asistencë. Identifikon burimin e problemit (software ose gabim anketuesi/kontrollori) dhe zgjidh problemin, e referon dhe e diskuton problemin me eprorin.
- Punon në grup, atëherë kur i ngarkohet, për të zhvilluar pjesë të caktuara të një aplikacioni.
- Kryen detyra të tjera që mund t'i ngarkohen.

Kriteret e përzgjedhjes:

- Të ketë përfunduar studimet universitare në Informatikë/ Informatikë Ekonomike/ Inxhinieri Informatike / shkenca kompjuterike;
- Diplomati, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;

Informacione të tjera:

Fushat e Njohurive:

1. Njohuri mbi sistemet e menaxhimit të bazave të të dhënave;
https://mrcet.com/downloads/digital_notes/ECE/III%20Year/DATABASE%20MANAGEMENT%20SYSTEMS.pdf
2. Koncepte mbi programimin e orientuar ndaj objekteve:

<http://www.instat.gov.al/media/8398/oo.pdf>

3. Koncepte mbi Microsoft SQL Server 2008

http://cdn.ttgtmedia.com/searchSQLServer/downloads/SQL_Components_Ch4_SS2008.pdf

Afati i aplikimit: 13.06.2022

Aplikimi realizohet nëpërmjet faqes së Institutit të Statistikave në seksionin e vëndeve vakante për pozicionet me kontrata të përkohëshme.

Copyright © 2022 Instituti i Statistikave